



ERZBISTUM  
HAMBURG

# Fjalimi baritor i aqipeshkvit të Hamburgut, Dr. Stefan Heße,

me rastin e kremtimit të festës  
së Shën Ansgar-it,  
më 03 shkurt 2020:



## Fjalimi baritor i aqipeshkvit të Hamburgut, Dr. Stefan Heße,

me rastin e kremtimit të festës  
së Shën Ansgar-it, më 03 shkurt 2020:

### **Të dashur motra dhe vëllezër!**

*„Mos e lini pas dore mikpritjen, sepse me anë të saj, disa, pa ditur, i pritën miq engjëjt!“*  
(HEB 13, 2). Ajo që tingëllon si një thënie nga një fletë e shkoqitur e kalendarit, është një nga virtytet më të rëndësishme të Shkrimit shenjt, e kjo është: mikpritja.

Në Besëlidhjen e Vjetër takimi i Abrahamit dhe i gruas së tij Sares me tre të panjohur është një shembull paralajmërues i miqësisë. Tre burra të huaj erdhën tek ata. Abrahami i përshëndeti dhe i takoi me sinqeritet dhe përzemërsi, pa e ditur se kë ka para vetes. Ai u ofroi burrave ujë për të pirë, poqi bukë të freskët dhe madje e preu një viq për të ngrënë. Mikpritja e tij është e paparamenduar, aq më tepër shumë pasionuese. Dhe në fund mysafirët i lanë atij madje më shumë sesa ai mund t'u jepte atyre. Papritur rolet ndërrohen: mysafirët bëhen mikëpritës. Ata i japin Abrahamit dhe Sares një perspektivë në të ardhmen. Ata ia shpallin çiftit, deri më tani pa fëmijë, lajmin e mirë, se Sara do të fitojë një fëmijë vitin e ardhshëm. Në këtë mënyrë, takimi me të huajt bëhet një pasurim i papritur i madh i jetës personale.

Në latinisht, në fakt, një shprehje e vetme përdoret për mysafirin dhe mikpritësin: hospes. Është një shenjë që tregon se si pritësi ashtu edhe i ftuari pasurohen dhe i dhurojnë njëri-tjetrit dhurata. Të gjithë përfitojnë nga mikpritja.

### **Të dashur të krishterë!**

Skena e gostisë së miqve të Abrahami mund të shihet në altarën e kishës tonë katolike, Shën Mëhilli, në Helgoland. Përshtatet pikërisht aty ku çdo ditë ka shumë mysafirë. Banorët e ishullit janë mikpritësit e tyre. Kjo përshtatet mirë gjithashtu në Kishën tonë: këtu të gjithë ne jemi mysafirë të Jezu Krishtit dhe si bashkësi mund ta dëshmojmë veten tonë në mikpritjen e shumë vizitorëve. Me këtë nuk mendoj vetëm në Kishën e



Helgolandit, por në tërë Arqipeshkëvinë tonë. Mikpritja është pjesë e stilit të mirë të Kishës tonë në të gjitha nivelet dhe në të gjitha vendet. Ajo nuk duhet të jetë çështje e natyrshme vetëm në vendet turistike, por kudo dhe për të gjithë. Mikpritja formon stilin e jetës tonë si të krishterë tejprëtej.

Me të dëgjuar fjalën mysafir, dikush mund të mendojë në një mysafir të hotelit, ndërsa tjetrin në një vizitë të ndonjë mbrëmjeje të këndshme. Megjithatë, mikpritja shkon më thellë: fjala greke për mikpritjen është *philoxenie*. Rrjedh nga *phileo* (të jesh mik) dhe *xenos* (i huaji). Mikpritja do të thotë dashuri për të huajin. Ajo është një miqësi me të huajin. Me fjalë të tjera: mikpritja do të thotë të takosh të huajin, të riun, të kundërtin, me mirësi dhe dashuri; ta mirëpresësh dhe ta pranosh me përzemërsi.

Në kohërat, kur nuk kishte një sistem hotelierie të zhvilluar, për shembull në kohën biblike të Abrahamit, mikpritja ishte thelbësore për mbijetesë. Bujtoret ishin vendet e sigurisë. Për shekuj, manastiret ishin vende të mikpritjes. Viteve të fundit, kjo domethënie jetëshpëtuese e mikpritjes ka marrë një rëndësi krejt të re në pritjen e shumë refugjatëve në vendin tonë. Falënderoj shprehimisht të gjithë ata, që angazhohen për ta, si në bashkësitë tona famullitare, ashtu edhe në komunat tona, dhe që janë nikoqirë të mirë në kuptimin më të thellë të fjalës. Do të doja, të mos detyrohem ta përmendja armiqësinë ndaj të hyajve, e cila fatkeqësisht ekziston.

Mikpritja është qëndrimi i brendshëm i Kishës sonë, e jo një fenomen dytësor. Zbulesa e Zotit në Jezu Krishtin nuk është thjesht një komunikim, por një takim personal. Kjo është arsyeja pse përmbajtja e besimit tonë të krishterë nuk mund të shkëputet kurrë nga forma e saj. Në këtë mënyrë, vetëbesimi ynë mund dhe duhet të tregohet në mikpritjen tonë të

gjallë. Nuk është rastësi, që Jezusi shkonte gjithnjë në vizitë tek njerëzit; mrekullinë e parë e bëri si mysafir në dasmën e Kanës. Gjithnjë i thërriste njerëzit tek vetja, në jetën e tij: *“Ejani e shikoni!”*

Për mua egzistojnë disa pika shumë konkrete, si ne, si ju mund ta mendoni dhe ta jetoni edhe me tutje mikpritjen:

1. Të gjithë jemi mysafirë në këtë tokë. Një nga këngët tona më të njohura mortore fillon me fjalët: „Ne jemi vetëm mysafirë mbi tokë“. Ajo vjen nga njëra prej kohërave më të errëta të historisë tonë gjermane. Në nacional socializëm, autori dëshironte t’i referohej shtëpisë sonë të fundit te Zoti. Shkojmë në takim të gostisë qiellore me Hyjin dhe të dashurit tanë. Kështu relativizohet gjithçka tjetër, por në asnjë mënyrë nuk bëhet e parëndësishme. Kjo ka pasoja për këtu dhe tani, për marrëdhëniet tona me këtë botë, me gjërat dhe me tërë jetën tonë. E bën të lehtë dhe të relaksuar, e çliron atë. Ajo gjithashtu ndikon në raportin tonë me krijimin, që na është besuar dhe që me përgjegjshmëri duhet t’iu kalojmë pasardhësve tanë. Të gjithë e kemi statusin e mysafirit në këtë tokë. Ju lutemi të sillemi si mysafirë të mirë!
2. Krishti na fton gjithmonë tek vetja. Ne mund të jemi mysafirët e tij. Le ta marrim këtë ftesë hyjnore gjithmonë me guxim! Ai dëshiron të na prijë në anën e Tij, që të mund ta dëgjojmë Atë dhe së bashku me Të ta kremtojmë Meshën shenjte. Thjesht, ne mund të jemi me Të në heshtjen e plotë. Në anën tjetër, vlen edhe fakti se: Zoti dëshiron të jetë mysafir në jetën tonë. Për shembull, Ai e fton vetveten në jetën e doganierit, Zakeut, ose te Marta e Betanisë: *“Sot do të vij të rri në shtëpinë tënde!”* Kështu, një lutje e njohur e bukës thotë: *“Eja, o Zot Jezus, bëhu mysafiri ynë!”*
3. Bashkësitë tona kishtarë pranojnë shumë ftesa. Ato mund të marrin pjesë në shumë aktivitete, të bashkëpunojnë në projekte dhe fushata në qytetet dhe komunat tona. Shumë prej tyre i gëzohen pranisë tonë. Ata na presin ne dhe përmbi të gjitha ata presin diçka nga ne. Jemi të kënaqur që na kërkohet një gjë e tillë. Vërtet, kjo nuk është aspak e parëndësishme. Do të ishte mirë nëse bashkësitë tona do t’u përgjigjeshin këtyre kërkesave me përkushtim.
4. Le të jemi përfundimisht mikpritës të mirë në famullitë tona dhe në të gjitha vendet e jetës kishtarë! Le t’i afrohemi miqve tanë, vizitorëve, të panjohurve dhe të huajve! Le të

jemi të ftuar me tërë qenien tonë! Ti përshëndesim përzemërsisht dhe të jemi vetë të afrueshëm (krah. Pastoraler Orientierungsrahmen II., 5). Gjithmonë duhet të brengosemi kur shohim pak ose aspak mysafirë në bashkësitë tona dhe nëse ata nuk ndjehen të mirëpritur. Për ta ndryshuar këtë, së pari është një çështje e qëndrimit dhe e zemrës, pikërisht bëhet fjalë për qëndrimin tonë. Shpeshherë mysafirët tanë na dhurojnë gjëra me mbushulli. Ne nuk jemi më vetëm mikpritësit e tyre, por mund të jemi mysafirë në jetën tyre.

**Të dashur motra dhe vëllezër,** mikëpritja është gjithmonë e paparamenduar. Ajo dëshiron t'i ofrojë tjetrit një hapësirë, në të cilën ai mund të hyjë dhe të bëhet mik. Këtu ndodh ajo që thotë teologu i ndjerë i kohëve të fundit nga Münsteri, Johann Baptist Metz: *Mbi të gjitha, „ne duhet të jemi në gjendje të harrojmë veten tonë, të tërhiqemi, në mënyrë që tjetri në mospërsëritjen e tij të arrijë vërtet te ne. Ne duhet të jemi në gjendje ta lejojmë atë brenda, ta lirojmë në veçantinë e tij, që shpesh na frikëson dhe na thërret në një transformim të dhimbshëm. Sepse sekretet e jetës nuk zbulohet në vetëmirësi, por në reciprocitet krijues“.* Le të jemi si Kishë në Arqipeshkëvinë e Hamburgut vërtet një Kishë në lidhje me Zotin dhe njerëzit! Le ta jetojmë thirrjen prej letrës së drejtuar Hebrenjve në një mënyrë konkrete dhe të përditshme: *„Mos e lini pas dore mikpritjen, sepse me anë të saj, disa, pa ditur, i pritën miq engjëjt!“*

Zoti ju bekoftë Juve dhe të gjithë ata, me të cilët na bashkon mikpritja!

Arqipeshkvi Juaj,



Dr. Stefan Heße



ERZBISTUM  
HAMBURG

Erzbistum Hamburg  
Am Mariendom 4  
20099 Hamburg  
[www.erzbistum-hamburg.de](http://www.erzbistum-hamburg.de)